



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË FERIZAJT PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Ferizajt për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Ferizajt (K.F), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Ferizajt, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Prezantim jo i saktë i detyrimeve të papaguara në PVF në vlerë prej 80,060€.
- B1 Prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në PVF në vlerë prej 127,975€.
- B2 Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontigjente në PVF në vlerë prej 2,600,648€.
- B3 Prezantim jo i saktë i pasurive në PVF, për shkak të nënvlerësimit për 192,138€, duke bërë që vlera e pasurive kapitale dhe jo kapitale të mos jetë e shpalosur saktë në PVF.
- B4 Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 787,464€.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Ferizajt kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Pajtueshmëria e transaksioneve për dhënjen në shfrytëzim të pronave komunale dhe monitorimi i tyre në Komunën e Ferizajt janë audituar veçmas për vitin 2023 dhe nuk janë pjesë e këtij raporti. Konkluzioni për pajtueshmëri për këtë kategori, do të paraqitet në një raport të veçantë të auditimit të pajtueshmërisë.”

Baza për konkluzion

- A2 Komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale në vlerë prej 2,326,548€ pa fonde të mjaftueshme financiare.
- A3 Komuna kishte kontraktuar shërbime përmes procedurës së hapur të prokurimit me operator ekonomik privat për shërbime të cilat ofrohen nga ndërmarrjet publike komunale.
- B5 Komuna gjatë vitit 2023, nuk kishte regjistruar 31 të punësuar në listën e pagave, të cilët kishin kontrata të rregullta të punës.
- B6 Si pasoj e vonesës në pagesën e detyrimeve financiare komuna ishte detyruar të paguante shpenzime shtesë në vlerë prej 254,260€ në emër të procedurës kontestimore/përmbartimore apo interesit për pagesë të vonuar.
- B7 Komuna kishte iniciuar procedurat e prokurimit pa një projekt detal (ekzekutiv) të ndërtimit.
- B8 Në katër (4) raste, komuna kishte bërë ndryshime të kontratave duke tejkaluar limitin e lejuar ligjor prej 10%.
- B9 Në 10 pagesa të testuara në vlerë 547,842€, kemi identifikuar se komuna ka përdorë fondet nga projektet për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.
- A4 Komuna kishte lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik me vlerë prej 30,768€, duke iu shmangur procedurave të prokurimit.
- A5 Komuna kishte financuar OJQ me vlerë prej 8,526€ duke iu shmangur thirrjes publike për financimin të OJQ-ve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Ferizajt.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Ferizajt është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Ferizajt në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Ferizajt me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Ferizajt.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm financiar dhe të pajtueshmërisë, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Dobësitë e evidentuara janë vërejtur në fushat të rëndësishme financiare si: Prezantim jo i saktë i detyrimeve të papaguara, llogarive të arkëtueshme, pasurive jo financiare dhe i detyrimeve kontingjente në PVF, klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme, pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve tjera, mungesa e projekteve ekzekutues, ndryshimi i kontratave të prokurimit duke tejkaluar limitin e lejuar ligjor, dobësitë në menaxhimin e obligimeve dhe shpenzimet shtesë përmbartimore, Shmangie e procedurave të prokurimit, Dobësi me rastin e nënshkrimit të kontratave për ofrimin e shërbimeve nga Autoritetet Publike etj. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Gjithashtu, duhet të theksojmë se për vitin 2023, Thesari kishte ekzekutuar përmes procedurave përmbartimore/gjyqësore vlerën prej 2,768,702€, prej tyre shpenzime të interesit dhe përmbartimit ishin 614,835€, për obligimet që kanë dalë nga kontrata kolektive. Këto shpenzime kanë të bëjnë me pagesat që janë bërë për shujta, inflacionin dhe kualifikimin për sektorin e arsimit.

Ky raport ka rezultuar me 21 rekomandime, prej tyre tetë (8) janë rekomandime të reja dhe 13 të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Prezantim jo i saktë i detyrimeve të pa-paguara në PVF

Gjetja

Neni 6 i Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Komuna nuk i kishte raportuar detyrimet e papaguara në vlerë prej 80,060€ për pagat e 31 punonjësve të cilët deri në fund të vitit 2023, nuk ishin regjistruar në listën e pagave. Këta punonjës ishin pranuar me procedura të rregullta të rekrutimit. Si rrjedhojë, kjo ka ndikuar në nënvlerësimin e obligimeve të papaguara të raportuara në PVF.

Kjo ka ndodhur pasi që drejtorja e arsimit në komunë nuk kishte hartuar një listë të punonjësve të cilëve nuk u janë paguar pagat.

Ndikimi

Prezantimi i detyrimeve të papaguara në vlera jo të sakta, ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF-ve të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën tyre.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës të mbajnë evidenca të sakta dhe të plota për detyrimet e papaguara dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të sigurohet se prezantimi i tyre në PVF është i saktë dhe i plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në PVF

Gjetja Neni 6 i Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatata buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Komuna në shtatë (7) raste, ka bërë prezantim jo të saktë të llogarive të arkëtueshme në PVF, në vlerë prej 127,976€ për gabimet e hasura si më poshtë:

- Llogaritë e arkëtueshme për taksën për lejet ndërtimore janë të nënvlerësuara për 38,868€, pasi që komuna nuk ka shpalosur këstet e papaguara për lejet ndërtimore. Në anën tjetër, ka pasur një mbivlerësim në vlerë prej 87,625€, për cilat komuna nuk ka ofruar dëshmi për vlerën e prezantuar. Po ashtu, në një rast tjetër tek dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, komuna kishte nënvlerësuar llogaritë arkëtueshme për 1,483€.

Komuna nuk ka një bazë të të dhënave ku mbahen shënimet e të gjitha llogarive të arkëtueshme, po ashtu nuk ka një komunikim të vazhdueshëm në mes drejtorisë së financave, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe drejtorive që mbledhin të hyra, si dhe funksionimi jo efikas i kontrolleve të brendshme në përditësimin e regjistrave kontabël dhe ruajtjen e dokumentacionit.

Ndikimi Prezantimi i llogarive të arkëtueshme në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën tyre.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për llogaritë e arkëtueshme dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të sigurohet se prezantimi i tyre në PVF është i saktë dhe i plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Prezantim jo i drejtë i detyrimeve kontigjente në PVF

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatata buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Komuna në 20 raste, ka bërë prezantim jo të drejtë të detyrimeve kontigjente në PVF, në vlerë prej 2,600,648€ për gabimet e hasura si më poshtë:

- Detyrimet kontingjente janë mbivlerësuar për 2,431,806€, nga të cilat 2,283,490€ janë si pasojë e prezantimit të lëndëve dy herë në PVF, për Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi. Po ashtu detyrimet kontingjente ishin nënvlerësuar në vlerë prej 168,842€, si pasojë e mos përfshirjes së lëndëve me të gjitha shpenzimet e parapara për të cilat mund të detyrohet komuna.

Prezantimi jo i drejtë i detyrimeve kontingjente në PVF kishte ndodhur për shkak se personat përgjegjës nuk kishin përditësuar vlerën e detyrimeve kontingjente të prezantuar në raport e pastaj edhe në PVF.

Ndikimi Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon në mbivlerësimin / nënvlerësimin e tyre, si dhe palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF-ve të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e detyrimeve që komuna pritet të ketë në të ardhmen.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet kontingjente të prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B3 - Mos regjistrimi i pasurive dhe prezantimi jo i plotë i tyre në PVF

Gjetja Sipas Rregullores Nr. 01/2017 Për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 6, "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Vlera e pasurive kapitale ishte nënvlerësuar për 192,138€⁵, për shkak se disa nga blerjet e vitit 2021 në vlerë prej 65,788€ dhe blerjet e vitit 2023 në vlerë prej 126,350€ nuk ishin regjistruar në SIMFK.

Mos funksionimi i kontrolleve dhe mungesa e komunikimit të mirëfilltë mes departamenteve ishin shkaktarët kryesor të mos regjistrimit të plotë të pasurisë.

Ndikimi Mos regjistrimi i të gjitha pasurive, rritë rrezikun që komuna mos të ketë nën kontroll të gjitha pasuritë e saj, dhe të ketë mangësi në raportim duke bërë nënvlerësimin e pasurive në PVF.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë rritjen e komunikimit mes departamenteve përkatëse me qëllim që të gjitha pasuritë e komunës të regjistrohen në regjistrin e pasurisë, në mënyrë që të ulët rrezikun e humbjes së pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve**Gjetja**

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Shpenzimi i parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në 14⁶ raste kemi identifikuar se komuna kishte ekzekutuar pagesa në kategori jo adekuate në vlerë prej 787,464€ si:

- Nga kategoria mallra dhe shërbime në vlerë prej 484,892€ ishin paguar për investime kapitale, 56,705€ për subvencione dhe transfere, ndërsa 50,665€ ishin paguar për paga dhe mëditje.
- Nga kategoria e investimeve kapitale vlera prej 71,000€ ishin paguar për mallra dhe shërbime si dhe 124,202€ për paga dhe mëditje.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse si dhe si pasojë e pagesave të ekzekutuara përmes vendimeve gjyqësore.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme, si dhe nënshkrimi i kontratës për projekt të pa planifikuar me ligjin e buxhetit

Gjetja

Sipas nenit 37.1 të Ligjit nr 03/L-221 për ndryshim dhe plotësim të ligjit nr. 0/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, Organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara. Sipas nenit 9.2 të Ligjit për prokurimin publik, ZKF siguron se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore, ZKF në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publik dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare do të sigurojë nëse janë ndarë mjete të mjaftueshme financiare për prokurimin përkatës në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të dalin si rezultat i prokurimit në fjalë gjatë vitit aktual fiskal, si dhe neni 9.3. Nëse autoriteti kontraktues organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.

Në shtatë (7) raste komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme financiare në kundërshtim me ligjin për ndarjet buxhetore dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve

- Komuna kishte lidhur kontratë për Rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe kanaleve ujore në Talinoc, Koshare, Terrn, Pleshinë, Greme dhe Gaqkë në vlerë të parashikuar prej 540,000€. Komuna për këtë projekt kishte fonde të ndara buxhetore për vitet 2023-2025, në vlerë prej 250,000€. Përkundër mungesës së buxhetit, komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa mbulesë buxhetore prej 290,000€.
- Komuna për realizimin e projektit Pjesëmarrja në projekte me donator, ujësjellësi në fshatin Sojeve, Dardani-faza II kishte lidhur një kontratë në vlerë prej 680,698€. Fondet buxhetore të ndara për këtë projekt ishin 482,078€, për tri vitet 2023-2025. Komuna ka bërë pagesa prej 200,000€ nga buxheti i këtij projekti për obligimet financiare që kanë rezultuar nga kontrata e fazës së parë. Si rrjedhojë për këtë projekt, komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa mbulesë buxhetore prej 398,620€.
- Për projektin Rikonstruktimi i rrugëve të reja në fshatrat Tërrn-Lubovc, Nerodime, Rakaj, Manastirc, Bibaj, Gaqkë, Prelez, Rahovicë, Greme, Komogllavë, komuna kishte lidhur kontratë kornizë me vlerë të parashikuar prej 1,000,000€ për tri vite, ndërsa sipas ligjit për ndarjet buxhetore të vitit 2023 për tri vite kishte të ndara 550,000€. Komuna ka hyrë në obligime kontraktuale për 450,000€, pa mbulesë buxhetore.
- Komuna kishte lidhur kontratë për projektin Pyllëzimi dhe rregullimi i parkut në kodrën e Sherreteve për dy lloje me vlerë 917,477€. Komuna për këtë projekt kishte 260,000€, fonde të ndara me ligjin e ndarjeve buxhetore për vitin 2023 dhe 460,000€ për vitet 2024 dhe

2025. Komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa mbulesë buxhetore për 197,477€.

- Komuna kishte lidhur kontratë për projektin Zgjerimin dhe rregullimin e parkut Liria në dy lloje me vlerë 698,756€. Komuna për këtë projekt kishte 150,000€, fonde të ndara me ligjin e ndarjeve buxhetore për vitin 2023 dhe 350,000€ për vitet 2024 dhe 2025. Komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa mbulesë buxhetore për 198,756€.
- Komuna kishte lidhur kontratë për projektin Ndërtimi i infrastrukturës së zonave turistike në fshatin Jezerc, në dy lloje me vlerë totale prej 791,927€. Komuna për këtë projekt nuk kishte fonde të ndara me ligjin e ndarjeve buxhetore për vitin 2023, 2024 dhe 2025. Kështu komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa mbulesë buxhetore prej 791,686€.
- Komuna kishte nënshkruar Marrëveshje për Shërbimet e Mirëmbajtjes së Rrugëve dhe Shesheve të Qytetit me nr. të protokollit 138/22 e datës: 17.05.2022, pa e siguruar disponueshmërinë e fondeve paraprakisht.

Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit, si dhe mos mungese se planifikimit të mirëfilltë buxhetore për projekte të caktuara.

Ndikimi

Hyrja në obligime financiare pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papagueshme financiare dhe shpenzimeve të përbarimit dhe anashkalim të ligjit të buxhetit si dhe vendimeve të kuvendit komunal për realizimin e projekteve kapitale, apo implikime buxhetore për vitin aktual dhe vijues.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha kontrollet e nevojshme funksionojnë gjatë tërë kohës, në mënyrë që para inicimit të procedurave të prokurimit të sigurohet se projektet kapitale janë të përfshira në ligjin e ndarjeve buxhetore ka fonde të mjaftueshme buxhetore të ndara me ligjin për ndarjet buxhetore për të gjitha kontrata e lidhura.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Mos kontraktimi i shërbimeve të cilat ofrohen nga ndërmarrjet publike komunale

Gjetja

Sipas nenit 9.4 të ligjit të prokurimit publike Nr. 04/L-042, Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik.

Për rregullimin e hapësirave të gjelbra, shesheve, rrugëve e nënkalimeve në qytet si dhe mirëmbajtja e tyre. Komuna më datën 23.10.2023 kishte lidhur kontratë kornizë me procedurë të hapur të prokurimit me një grup operatorësh ekonomike në vlerë prej 1,600,000€. Komuna nuk kishte ndërmarr asnjë veprime apo masa formale të arsyeshme për t'u siguruar se për këtë lëndë/procedurë të prokurimit nuk do të mund të përmbushin kërkesat e kësaj procedure të prokurimit nga ndonjë autoritet tjetër publik apo nuk ofrohen nga ndonjë ndërmarrje publike komunale. Komuna ka në pronësi dy ndërmarrje publike komunale, ku nga këto dy ndërmarrje publike komunale, komuna deri në shtatorë të viti 2023 ka blerë shërbime që kanë

qenë lënde e kësaj procedura/kontrate të prokurimit.

Zyrtarët nuk kanë ofruar ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore.

Ndikimi Mos kontraktimi i shërbimeve të cilat ofrohen nga ndërmarrjet publike komunale përveç që ndikon në aspektin financiar të kompanisë pronare e të cilës është vet komuna, po ashtu ndikon që komuna të kontraktoj këto shërbime me një çmim më të lartë.

Rekomandimi A3 Kryetari të sigurojë se para inicimit të procedurave të prokurimit, lënda e prokurimit/shërbimet publike nuk ofrohen nga një ndërmarrje publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B5 - Zyrtarë jashtë listës së pagave dhe hyrja në obligime pa buxhet të aprovuar

Gjetja Rregulla financiare e MF-së Nr. 01-2013, neni 33 parasheh që Organizata Buxhetore duhet të siguroj që të gjithë personat në marrëdhënie pune të paguhen përmes listës së pagave. Po ashtu edhe Ligji Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e RKS për vitin 2023, neni 12.1 përcakton: Asnjë organizatë buxhetore nuk mund të tejkaloj numrin e të punësuarve në nivel të nën-programit, në asnjë kohë gjatë viti fiskal 2023, siç specifikohet në tabelën 3.1, 3.1A dhe 4.1 të bashkangjitura në këtë ligj, përveç lehonive në sistemin shkollor para universitar.

Komuna, gjatë vitit 2023 nuk i kishte regjistruar në listën e pagave 31 punonjës, derisa në vitin 2022 kishte 18 punonjës jashtë listës së pagave. Për më shumë, komuna kishte tejkaluar numrin e lejuar të punonjësve me ligjin e buxhetit e po ashtu kishte hyrë në obligime pa buxhet. Këta punonjës ishin pranuar me procedura të rregullta të rekrutimit.

Kjo ka ndodhur për shkak se në arsim është shtuar numri i paraleleve më shumë se sa ishin në planin për regjistrimin e nxënësve në klasat e 10-ta për vitin shkollor 2023/2024, mungesat me arsye të mësimdhënësve dhe pushimet e lehonisë. Më tutje, mos vendosja e punonjësve në listën e pagave, është edhe për shkak se, është tejkaluar numri i lejuar sipas Ligjit të buxhetit.

Ndikimi Mos përfshirja e punonjësve në listën e pagave, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara si dhe vonesat e pagesave rrisin rrezikun e shpenzimeve shtesë përmes procedurave gjyqësore/ përmbarimore.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurohet, se planifikimet buxhetore për paga dhe shtesa t'i paraprijë një analizë e detajuar lidhur me nevojën e shtimit të numrit të paraleleve, rrjedhimisht e punonjësve në sektorin e arsimit me qëllim të parandalimit të hyrjes në obligime pa buxhet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B6 - Dobësitë në menaxhimin e obligimeve dhe shpenzimet shtesë përmbartimore

Gjetja Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në 14⁷ raste, faturat në vlerë prej 403,804€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat në ekzekutimin e pagesave arrinin deri 581 ditë kalendarike.

Po ashtu, është e rëndësishme të theksojmë se nga analiza e raportit të shpenzimeve rezulton se vonesat në kryerjen e obligimeve financiare kanë shkaktuar shpenzime shtesë për mes proceseve gjyqësore/përmbartimore. Këto pagesa janë realizuar nga buxheti i komunës për vitin 2023, në një vlerë prej 2,400,382€. Nga kjo vlerë, 2,146,122€ ishte borxhi kryesor i papaguar, ndërsa 254,260€ janë shpenzime shtesë të realizuara për proceset kontestimore/përmbartimore ose interesat e tjera të përfshira.

Kjo kishte ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur fonde buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve.

Ndikimi Vonesat në realizimin e pagesave brenda afatit kohor, ka ndikuar që komuna të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbartimore.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha informatat për faturat e papaguara të dorëzohen me kohë tek Zyrtari Kryesor Financiar për të shmangur tejkalimin e afatit ligjor për ekzekutimin e pagesave. Kjo do të reduktojë rrezikun e padive nga operatorët ekonomikë dhe do të parandalojë shpenzime shtesë të interesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B7 - Mungesa e projektit ekzekutues**

Gjetja Paragrafi 19.17 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ndër tjerash parasheh se Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Komuna ka filluar procedurat e prokurimit dhe ka lidhur kontrata për projektet si në vijim, pa u hartuar paraprakisht projektet ekzekutive:

- Meremetimi i aneksit të shkollës fillore ish Shaban Hashani në Ferizaj - faza e dytë, me një vlerë prej 327,552€,
- Rikonstruimi i rrugës në fshatin Prelez të Jerlive, me një vlerë prej 169,250€,

- Ndërtimi i silloseve për ruajtjen e grurit, me një vlerë prej 999,508€, dhe
- Ndërtimi i trotuarit në Dremjak-Kosine, me një vlerë prej 188,709€.

Zhvillimi i procedurave të prokurimit në mungesë të projektit ekzekutues ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve nga njësitë kërkuese, pa bërë paraprakisht hartimin e projekteve ekzekutive zbatuese dhe mos funksionimit efikas të kontrolleve tek zyra e prokurimit duke i zhvilluar procedurat pa u përmbushur kërkesat ligjore.

Ndikimi Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv, mund të ndikoj në realizim të dobët të kontratave për punë si dhe mund të shkaktojë shpenzim të paparashikuar apo vlerë të dobët për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit, paraprakisht të bëhet hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Ndryshimi i kontratave të prokurimit duke tejkaluar limitin e lejuar ligjor

Gjetja Sipas Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 71.12 Modifikimi duhet të konsiderohet si thelbësor kur plotësohen një ose më shumë nga katër kushtet, si më poshtë: d) Në rast se ndryshimi i propozuar i kontratës përfshin furnizimet, shërbimet apo punët të një cilësie tjetër nga ajo që ishte përcaktuar në kontratën fillestare do të konsiderohet ndryshim thelbësor, kur: (i) Ndryshimet në kontratë tejkalojnë 10% të vlerës së kontratës në rastin e kontratave publike për furnizim, shërbime dhe punë shtesë.

Në vijim janë prezantuar ndryshimet e sasive nëpër pozicionet e kontratave:

- Asfaltimi i rrugës që lidh lagjen Omuraj me lagjen Spahiaj në vlerë 549,881€, ishin bërë ndryshime të sasive nëpër pozicione në vlerë prej 214,453€ apo 39% të vlerës së kontratës.
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sojeve, Dardani dhe Mirosale në vlerë 386,202€ ishin bërë ndryshime të sasive nëpër pozicione në vlerë prej 108,897€ apo 28% të vlerës së kontratës.
- Rregullimi i kanalizimit në fshatin Zaskok dhe asfaltimi i rrugëve në Doganaj në vlerë 198,989€, ishin bërë ndryshime të sasive nëpër pozicione në vlerë prej 93,303€ apo 46% të vlerës së kontratës.
- Infrastruktura nëntokësore dhe asfaltimin e rrugicave të mbetura në qytet projekt dy vjeçar Loti II, me vlerë 689,726€ ishin bërë ndryshime të sasive nëpër pozicione në vlerë prej 233,990€ apo 34% të vlerës së kontratës.

Aprovimet për gjitha ndryshimet e sipërmendura ishin marr nga Zyrtari Kryesor Administrativ, ndryshimet nuk kanë kaluar vlerën totale të kontratës, por kishin tejkaluar limitin e lejuar ligjor të ndryshimeve prej 10%.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së kontrollit në zbatimin e kushteve të përcaktuara ligjore dhe inicimit të procedurave të prokurimit dhe lidhja e

kontratave për projekte ndërtimore është bërë pa një plan detal ekzekutiv të ndërtimit.

Ndikimi Tejkalmi i limiteve të lejuara në kontratë, tregon se planifikimi dhe përgatitjet e kontratave kanë dobësi të theksuara që ndikon në rritjen e obligimeve të paplanifikuara.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë që nuk autorizohet ndryshimi i kontratave përtej limiteve të lejuara nga ligji i prokurimi publik prej 10% të vlerës totale të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B9 - Pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve tjera

Gjetja Sipas neni 16 pikës 11 të Ligjit Nr. 08-L-193 Ndarjet buxhetore për vitin 2023, ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese apo zëvendësimin e projekteve kapitale të komunave, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal. Rialokimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat dhe kriteret e parapara me udhëzimin administrativ MF. Nr. 05/2019 për procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore.

Në 10⁸ pagesa të testuara në vlerë prej 547,842€, kemi identifikuar se komuna ka përdorur fondet për projekte tjera nga ato për të cilat ishin planifikuar/buxhetuar. Në këto raste, nuk ka pasur aprovim nga Kuvendi Komunal për ridestinim të fondeve dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.

Zyrtarët nuk kanë ofruar ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore. Megjithëse, kjo situatë është përsëritur, veprimet e tilla janë të ndikuara nga planifikimi jo i mirë i projekteve.

Ndikimi Përdorimi i fondeve për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin buxhetuar pa një aprovim paraprak nga kuvendi komunal dhe ministri i financave, përveç që është në kundërshtim me ligjin e buxhetit, ndikon që të devijohen projektet nga ato të aprovuara në kuvendin komunal, në të cilin janë diskutuar dhe aprovuar prioritetet e qytetarëve.

Rekomandimi B9 Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestinim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuara me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Shmangie e procedurave të prokurimit**Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenit 2, paragrafi 2 "Ky ligj vlen për të gjithë personat, operatorët ekonomik, dhe ndërmarrjet, ashtu si përcaktohen këto terme në këtë ligj, që janë të përfshirë, marrin pjesë ose interesohen, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në aktivitete prokurimi të rregulluara me këtë ligj; nga personat e tillë, operatorët, dhe ndërmarrjet gjithashtu kërkohet që t'i respektojnë dhe të veprojnë në përputhje me kërkesat procedurale dhe materiale të këtij ligji" si dhe Referuar Rregullores Nr. 001/2022 përkatësisht neni 70, paragrafi 5 "Pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, Zyrtari përgjegjës i /Prokurimit do ta informojë Zyrtarin Kryesor Administrativ (ZKA). ZKA me shkrim do ta emërojë një Menaxher të Kontratës përgjegjës për menaxhimin e kontratës specifike dhe një mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës".

Tek marrëveshja e bashkëpunimit për realizimin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik, komuna kishte shmangur procedurat e prokurimit duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Organizatën Jo Qeveritare Agjensioni i Zhvillimit Rajonal - Lindje, për angazhimin e stafit në cilësinë e konsulentëve, përkatësisht ekipit për projekte me interes për komunën. Vlera e marrëveshjes në fjalë ishte 30,768€. Gjithashtu, komuna për rastin në fjalë nuk kishte emëruar menaxher të kontratës sikur edhe kërkohet me ligjin në fuqi.

Mos funksionimi i kontrolleve të brendshme nga ana zyrtarëve përgjegjës, ishte shkak që nuk kishin iniciuar procedurat e prokurimit publik dhe nuk kishin emëruar menaxher kontrate.

Ndikimi

Anashkalimi i procedurave të prokurimit, përveç që dëmtojnë konkurrencën, transparencën e procesit, efikasitetin dhe efektivitetin e veprimeve po ashtu rrisin rrezikun e mos arritjes së vlerës për paranë e shpenzuar dhe mundësisë së përballjes me vështirësi apo edhe humbje financiare të komunës. Gjithashtu, mungesa e caktimit të një personi përgjegjës për monitorimin e projektit rrit rrezikun që projekti në fjalë të mos arrij qëllimin për çka është iniciuar.

Rekomandimi A4

Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se janë zbatuar procedurat e prokurimit për të gjitha furnizimet dhe shërbimet të cilat janë objekt i prokurimit publik. Gjithashtu, Kryetari të sigurohet që për projektet e komunës të caktoj Menaxher Kontrate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A5 - Financimi i organizatave jo-qeveritare jo në pajtim me rregulloren e MF-së.****Gjetja**

Sipas Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, përkatësisht Neni 2 Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga çdo organizatë buxhetore e cila financon projektet dhe programet e OJQ-ve të cilat janë aplikues apo partner në aplikimet, sipas një thirrje publike për financim të projekteve dhe programeve të OJQ-ve, dhe të cilat i plotësojnë kriteret sipas kësaj Rregulloreje.

Komuna ka lidhur Memorandumin e Mirëkuptimit me Organizatën Jo-qeveritare Play International në vlerë prej 8,526€ për zbatimin e projekteve arsimore, duke anashkaluar thirrjen publike për financimin e këtij projekti. Qëllimi i projektit ishte trajnimi i mësimeve dhe aktivitete nga të rinjtë përkatësisht vizitë studimore në shtetin e Francës.

Mos funksionimi i mirëfilltë i kontroleve dhe mungesa e njohurive lidhur për aplikimin e procedurës adekuate me rastin e financimit të OJQ-së në fjalë, ishte shkak i financimit të projektit pa zhvilluar procedurat adekuate.

Ndikimi

Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit pa përfillur kërkesat ligjore lidhur me procedurat përkatëse rrit rrezikun që fondet e shpenzuara të mos arrijnë objektivat për çka janë destinuar, gjithashtu e njëjta kufizon mundësinë e pjesëmarrjes së OJQ-ve tjera me projekte që potencialisht mund të ofronin vlerë më lartë për parën.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurohet që të respektohen kërkesat ligjore lidhur me përcaktimin e procedurave adekuate me rastin e financimit të Organizatave Jo-qeveritare, duke marrë për bazë kërkesat që dalin nga rregullorja 04/2017 për subvencionim të OJQ-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2023 ishin në vlerë prej 7,868,804€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, në vlerë prej 3,618,562€, (në këtë shumë përfshihet edhe Tatimi në Tokë). si dhe të hyrat tjera jo tatimore në vlerën prej 4,250,242€ (të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Në totalin e të hyrave të realizuara janë përfshirë edhe të hyrat indirekte nga gjobat në Trafik në vlerë prej 979,371€, gjobat e Gjykatave 122,855€ dhe të hyrat nga Agjencia e Pyjeve 16,099€.

Çështja A6 - Lëshimi i lejeve të ndërtimi në tokat ku kishin për destinim llojin e shfrytëzimit tokë bujqësore

Gjetja

Sipas 13.1 të ligjit për tokën bujqësore Nr. 02/L-26, Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të jetë i përhershëm dhe i përkohshëm. a) ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore konsiderohet çdo ndërrim i destinimit i cili bëhet për ndërtimin e vendbanimeve, objekteve industriale, hekurudhave, komunikacionit rrugor, rezervuarëve të ujit, aeroporteve, linjave të ndryshme instaluese apo objekteve të tjera të cilat përgjithmonë pamundësojnë shfrytëzimin e tokës bujqësore për prodhimtari bujqësore, si dhe neni 14.1. Të gjithë personat fizik dhe juridik duhet ta paguajnë kompensimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime jo bujqësore, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Po ashtu sipas nenit 19, Organi kompetent komunal përkatësisht organi tjetër kompetent për dhënien e lejes për ndërtim të objektit apo për kryerjen e punëve, mund të jap leje nëse investitori apo shfrytëzuesi përveç dokumentacionit tjetër të nevojshëm paraqet edhe dëshmi për pagesën e kompensimit për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

Në pesë (5) raste, kemi identifikuar që Drejtoria e Urbanizimit kishte lëshuar leje të ndërtimit në tokë që ishte e destinuar si tokë bujqësore, pa u përfunduar fillimisht procedurat e ndërrimit të destinimit të tokës, dhe pa u kryer pagesa e taksës që sipas tarifës është dashur të paguhet në vlerë prej 8,076€ për ndërrim të destinimit të tokës siç kërkohet me ligjë.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së monitorimit nga ana e menaxhmentit të Komunës për drejtorin e urbanizimit.

Ndikimi

Lëshimi i lejes së ndërtimit në tokë që ka destinimin për bujqësi, pa u kryer procedurat e ndërrimit të destinimit ka dëmtuar buxhetin e komunës për 8,076€, pasi që nuk është kryer pagesa nga ana e aplikuesit.

Rekomandimi A6

Kryetari të sigurohet se kontrollet përkatëse në shqyrtimin e kërkesave të lejeve të ndërtimit janë funksionale gjatë gjithë kohës së operimit, dhe se para lëshimit të lejes së ndërtimit të sigurohet që janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 12,963,373€, prej tyre ishin shpenzuar 12,815,214€ apo rreth 99% të buxhetit final. Shpenzimet për investime kapitale kanë të bëjnë me asfaltimin e rrugëve lokale, kanalizime, shpronësime, objekte arsimore e shëndetësore.

Çështja A7 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

Gjetja	<p>Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.</p> <p>Menaxherët e kontratave/projekteve nuk e kanë mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së funksionimit të kontrolleve të brendshme për ta kryer këtë proces nga ana e menaxherëve të projekteve.</p>
Ndikimi	<p>Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë të kontratave si dhe nuk ofron mundësi e mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.</p>
Rekomandimi A7	<p>Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B10 - Specifikimi teknik jo i qartë/matshëm

Gjetja	<p>Sipas nenit 28.4 të LPP-së, autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim, gjithashtu neni 28.8 Kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'i lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën. Dhe sipas 28.7 Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.</p> <p>Çështjet që janë identifikuar të specifikimet teknike janë të projektet në vijim si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Asfaltimi i rrugës në Gaqë - Topojan dhe në lagjen Bajram Curri, në vlerë prej 199,939€, në formulimin e specifikave teknike ishin bërë përkrahje jo të sakta dhe jo të matshme të pozicioneve si: nuk ka përcaktuar standardin e cilësisë së punimeve apo produkteve të kërkuara, duke kërkuar vetëm: Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltbetonit AB0-16mm, por pa u përcaktuar standardi i asfaltit, pra pa përcaktuar metodë testimi për matjen e temperaturës së
---------------	---

përzierjeve të nxehta bituminoze pas përzierjes dhe gjatë ruajtjes, transportit dhe shtrimit. Dobësitë e ngjashme të sipërmendura janë vërejtur njëjtë edhe për projektin, Rikonstruimi i rrugës Ahmet Kaqiku - faza II, në vlerë prej 99,977€.

- Ndërtimi i Sallës së Sporteve dhe Rregullimi i oborrit në shkollën Astrit Bytyçi Ferizaj, në vlerë prej 297,382€, në formulimin e specifikave teknike, komuna ka bërë përshkrime teknike jo të matshme të furnizimi dhe montimi i dyerve dhe dritareve duke mos përcaktuar trashësinë e profilit të kornizës apo numrit të urave termike apo furnizimin me pllaka qeramike duke mos përcaktuar trashësinë e pllakave qeramike.

Specifikimet teknike jo të qarta/matshme, kanë ndodhur për shkak se njësitë kërkuese nuk kanë bërë rishikim adekuat dhe në mënyrë profesionale, për të eliminuar paqartësitë, dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk ka ushtruar kontrolle të mjaftueshme për të parandaluar këtë mangësi.

Ndikimi

Mos përcaktimi i saktë i standardit të kualitetit të punimeve apo produkteve të kërkuara ndikon që mbikëqyrja e kontratave të mos jetë efikase dhe punimet të kryhen me kualitet të dobët. Kjo bënë që operatorët ekonomik të jenë të keq orientuar dhe mund të ndikoj në ofertën financiare dhe çmimin e kontratës.

Rekomandimi B10

Kryetari duhet të siguroj kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese të bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B11 - Vonesa në realizimin e kontratës

Gjetja

Sipas nenit 10.2 të kushteve të veçanta të kontratës, përfundimi i të gjitha punëve do të duhej të kryheshin brenda tri (3) viteve.

Në rastet e mëposhtme janë vërejtur vonesa në realizimin e punëve të kontratave në vijim:

- Kontrata Ndërtimi i shkollës së mesme në komunën e Ferizajt në vlerë 1,803,726€ e nënshkruar më 20.01.2017, kishte vonesa në përfundimin e projektit. Punimet duhej të përfundonin më 20.11.2020 sipas kontratës bazë. Mirëpo deri në dhjetor të vitit 2023 punimet nuk ishin përfunduar.
- Kontrata Ndërtimi i kabinave për pritjen e udhëtareve në vend qëndrimet e autobusëve në vlerë 33,203€ ishte nënshkruar më 18.05.2022 dhe afati për përfundimin e të gjitha punimeve ishte 12 muaj. Mirëpo deri më 11.04.2023 ishte përfunduar vetëm 38% e punëve, dhe për vonesat në realizimin e kontratës komuna nuk ka aplikuar penale siç parashikohen me kontratë.
- Kontrata Ndërtimi i sallës së sportit në fshatin Balaj 270,185€, ishte nënshkruar më 17.09.2018 dhe afati për përfundimin e të gjitha punimeve ishte dy (2) vite, por deri në qershor 2023 ende nuk ishte përfunduar.

Vonesat kishin ndodhur për shkak të problemeve me paramasa të kontratave të iniciuara pa projekte detale të ndërtimit.

Ndikimi Mos përmbushja e kontratës sipas kushteve të specifikuara në kontratë, tregon se planifikimi dhe përgatitjet e kontratave kanë dobësi të theksuara, duke ndikuar që punët të vonohen dhe mos realizohen siç ishin me kontratë. Problemet e tilla mund të sjellin edhe vështirësi financiare.

Rekomandimi B11 Kryetari duhet të siguroj se janë eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratave sipas kushteve të kontratës para inicimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale, ashtu që realizimi i kontratës të mos ketë pengesa dhe vonesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PVF e pasurive kapitale është 237,167,303€, pasurive jokapitale është 1,127,203€ si dhe e stoqeve 90,070€.

Çështja B12 - Mangësi në inventarizimin e pasurisë

Gjetja Sipas neni 19.4.3 të rregullores Nr. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është përgjegjës për krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe identifikimin e pasurisë që nuk ka vlerë të bartur. Po ashtu, sipas nenit 4.1 Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën.

Komuna e kishte kryer inventarizimin e pasurisë, mirëpo nuk kishte bërë harmonizimin/krahasimin me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Komuna nuk ka aprovuar rregulla dhe procedura të brendshme për ndarje të drejt të detyrave për regjistrimin dhe raportimin e pasurive, evidencën dhe ruajtjen e pasurive, ngarkimin e pasurive tek personat përgjegjës që do të kujdeseshin për pasuritë e ngarkuara apo edhe procedurën e inventarizimit dhe krahasimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të komunës sa i përket fushës së pasurisë.

Ndikimi Mungesa e rregullave të brendshme dhe mos krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë, ka vështirësuar menaxhimin efektiv të pasurisë. Mos krahasimet e raporteve me regjistrat e pasurive, nuk japin siguri për gjendjen faktike të tyre, më tutje, kjo mund të ndikoj në humbjen apo keqpërdorimin e pasurisë.

Rekomandimi B12 Kryetari duhet të sigurohet se bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë si dhe azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Kryetari duhet të analizoj nëse është e nevojshme hartimi i procedurave dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurisë së komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Mos-funksionalizimi i sistemit e-pasuria

Gjetja Sipas Rregullores Nr. 02/2013 - Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6 thekson se, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Komuna, nuk kishte përdorur softuerin sistemin e-pasuria për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve. Në mungesë të përdorimit të sistemit e-pasuria, komuna kishte evidentuar këto pasuri në një bazë të dhënave në formatin Excel.

Kjo situatë ishte shkaktuar si rezultat i mungesës së veprimeve të nevojshme për ta funksionalizuar sistemin e-pasuria.

Ndikimi

Mirëmbajtja manuale e të dhënave rrit mundësinë e gabimeve në mirëmbajtjen e regjistrave, shlyerjeve potenciale, keqpërdorimit, humbjes apo të tjetërsimit tyre.

Rekomandimi A8

Kryetarit duhet të sigurohet që të funksionalizoj sistemin e-pasuria me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga ligjet në fuqi dhe sigurisë së informatave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

Komuna në PVF-të e vitit 2023 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 17,120,442€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 12,744,750€, leje ndërtimore 4,207,770€, qiraja 165,466€ dhe çerdhja 2,455€.

Çështja B13 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenin 26 të ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme Nr. 06/L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesën, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Sipas nenit 14 të Rregullores Nr. 01/186 - për taksa tarifa dhe gjoba komunale, përcaktohet që për mospagimin e taksave dhe ngarkesa të përcaktuara në rregullore, në afatin të cilin e përcakton organi zyrtar përkatës, për të cilat ka faturë iniciohet procedura përmbarimore.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme, pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Sipas pasqyrave vjetore financiare të vitit 2023, në raport me vitin paraprak, ato janë rritur për 857,337.30€. Komuna nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim konkret për mbledhjen/realizimin e llogarive të arkëtueshme. Rritja më e madhe ishte te taksa për lejet e ndërtimit dhe tatimi në pronë.

Sipas komunës gjendja ekonomike e sociale e komunës, ka ndikuar, deri te mos pagesa e borxheve tek tatimi në pronë, derisa sa i përket bizneseve komuna nuk na ka dhënë ndonjë arsye konkrete pse nuk është duke ndërmarr veprime për inkasim.

Ndikimi Rritja e llogarive të arkëtueshme nëpër vite, dhe mos marrja e veprimeve për inkasim të tyre, ndikon në përkeqësimin e performancës së inkasimit të këtyre llogarive. Në anën tjetër, ndikohet trendi negativ i rritjes vit pas viti duke rrezikuar arkëtimin e tyre, si dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi B13 Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁹	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	38,103,752	45,615,583	45,328,253	36,730,534	35,241,146
Grante Qeveritare - Buxheti	31,667,828	35,905,183	35,744,461	28,081,163	28,616,373
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	235,608	79,477
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	0	0	0	0	1,779,340
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,927,551	1,927,084	2,174,905	656,349
Të hyrat vetanake	6,435,924	7,717,667	7,612,849	5,900,940	4,025,196
Donacionet vendore	0	15,797	788	44,047	79,676
Donacionet e jashtme	0	49,386	43,070	293,871	4,736

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 7,511,831€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së garantit prej 4,237,355€, rritjes nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2023 në vlerë 1,281,743 dhe nga të hyrave të bartura nga viti paraprak 1,927,551€, rritjes së donacioneve të brendshme dhe të jashtme me 65,182€.

Në vitin 2023 Komuna e Ferizajt ka shpenzuar 99.37% të buxhetit përfundimtar, pothuajse i njëjtte në krahasim me vitin 2022, ku realizimi ishte 99.62%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	38,103,752	45,615,583	45,328,253	36,730,534	35,241,146
Pagat dhe mëditjet	16,331,588	20,585,295	20,572,860	16,339,440	17,568,098
Mallrat dhe shërbimet	7,507,500	9,376,282	9,322,932	6,686,492	5,099,813
Komunalitë	950,000	1,100,633	1,091,842	927,992	699,321
Subvencionet dhe transferet	1,200,000	1,590,000	1,525,404	1,493,631	1,101,033
Investimet Kapitale	12,114,664	12,963,373	12,815,214	11,282,980	10,772,882

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


-Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,253,707€. Kjo rritje është: 4,237,355€ nga Granti qeveritar dhe 16,352€ nga Granti i donatoreve.

-Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,019,415€. Ky ndryshim buxhetor është nga të hyrat vetanake 56,743€, të hyrat e bartura në shumë 1,927,551€, dhe donacionet 35,121€.

-Buxheti final për subvencione kishte rritje për 390,000€, kjo rritje ishte nga të hyrat vetanake sipas tejklimit të planifikimit për vitin 2023.

-Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar kishte rritje për 848,709€. Kjo rritje ishte nga të hyrat vetanake sipas tejklimit të planifikimit për vitin 2023, me vlerë 835,000€, si dhe nga granditë e donatorëve 13,709€. Një pjesë e kësaj rritje të buxhetit është dedikuar për projektet të reja si sera bujqësore e participim për lope dhe blegtori, mjete konkretizimi, pajisje të teknologjisë informative.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2023 ishin në vlerë prej 7,868,804 €. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, në vlerë prej 3,618,562€, (në këtë shumë përfshihet edhe Tatimi në Tokë), si dhe të hyrat tjera jo tatimore në vlerën prej 4,250,242€ (të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj, Në totalin e të hyrave të realizuara janë përfshirë edhe të hyrat indirekte nga gjobat në Trafik në vlerë prej 979,371€, gjobat e Gjykatave 122,855€ dhe të hyrat nga Agjencia e Pyjeve 16,099€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	6,435,924	6,435,924	7,868,804	6,437,271	5,188,599
Të hyrat tatimore	4,048,621	4,048,621	3,618,562	2,783,469	2,510,636
Të hyrat jo tatimore	2,387,303	2,387,303	4,250,242	3,653,803	2,677,962

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të të vitit 2022 të Komunës së Ferizajt ka rezultuar në 19 rekomandime kryesore. Komuna e Ferizajt kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Komuna nuk kishte mbajtur ndonjë dëgjim publik lidhur me zbatimin e rekomandimeve nga raporti i ZKA. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, ndërsa 13 rekomandime nuk janë zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të kontratave, për tu siguruar se pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të mjaftueshme për kryerjen e punëve të kontraktuara në përputhje me kushtet të kontratës.	Komuna kishte marrë masa për ta zbatuar këtë rekomandim dhe në këtë vite nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar

2.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të që para shtimit të numrit të paraleleve të sigurohet se ka në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për çdo pozitë për rekrutim dhe ka vende të lira për përfshirjen e tyre në listën e pagave.	Nuk janë ndërmarrë veprime për ta zbatuar këtë rekomandim edhe këtë vit komuna kishte punëtor jashtë listës së pagave, rekomandimi nuk ishte zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha informatat për faturat e papaguara dorëzohen me kohë tek Zyrtari Kryesor Financiar me qëllim të mos tejkalimit të afatit ligjor për ekzekutimin e pagesave.	Nuk janë ndërmarrë veprimet ku nga mostrat e testuar kemi vërejtur se komuna nuk i kishte bërë pagesat e faturave brenda afatit kohor se kishte pagesa përmes procedurave gjyqësore/përmb aruesve.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të siguroj që zyra prokurimit të dorëzoj raporte të plota për kontratat e nënshkruara krahas kërkesave ligjore, gjithashtu të bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese të cilat duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim në mënyrë që të shmangen ndarja e punëve apo furnizimeve me qëllim të shmangies së procedurave të hapura të prokurimit.	Zyra e prokurimit ka dorëzuar raporte të plota sipas kërkesave ligjore.	I zbatuar
5.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj se njoftimet për dhënie të subvencioneve, të jenë të planifikuara, duke siguruar paraprakisht fondet e mjaftueshme, dhe që njëkohësisht vlerësimi dhe përzgjedhja e përfituesve të bëhet në mënyrë transparente duke mos diskriminuar asnjë aplikues.	Vlerësimi dhe përzgjedhja e përfituesve ishte bërë sipas kriterëve të njoftimit për subvencionim.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit, në mënyrë që zyrtarit përgjegjës të prokurimit të kërkoj konfiskimin e sigurimit të tenderit çdo herë që OE nuk iu përgjigjen kërkesave të zyrës së prokurimit që janë kërkesa të dosjes së tenderit.	Rekomandim i zbatuar	I zbatuar

7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit, paraprakisht të bëhet hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Nuk janë ndërmarrë veprimet edhe në vitin 2023 komuna kishte inicuar procedura të prokurimit pa plan detal të ndërtimit.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj që nuk autorizohet ndryshimi i kontratave përtej limiteve të lejuara nga ligji i prokurimi publik prej 10% të vlerës totale të kontratës.	Komuna nuk kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim edhe këtë vit komuna ka lidhur kontrata me paramasa jo sipas nevojave reale duke shkaktuar nevojën për ndryshime të kontratave duke tejkaluar limitet ligjore.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestnim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuara me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.	Edhe këtë vit kemi hasur që janë bërë pagesa duke përdorur fonde nga projektet jo për të cilat ishin të aprovuara.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se janë eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratave sipas kushteve të kontratës para inicimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale, ashtu që realizimi i kontratës të mos ketë pengesa dhe vonesa.	Nuk janë ndërmarrë veprimet edhe këtë vit kemi hasur disa projekt që ishin vonuar në përfundimin e punimeve.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	Nuk janë ndërmarrë veprimet edhe në vitin 2023 në procedurat e iniciuara të prokurimit kemi hasur që Specifikimi teknik ishte jo i qartë/matshëm.	Nuk ka filluar zbatimin

12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se funksionon kontrolli i duhur nga zyrtari përgjegjës i prokurimit duke zbatuar kërkesat e kornizes ligjore, ashtu që, në asnjë procedurë të hapur të prokurimit nuk vendosen kriteret diskriminuese që kufizojnë konkurrencën apo mund të favorizojnë një operator ekonomik apo një grup operatorësh ekonomik. Po ashtu, Kryetari të sigurojë kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit në mënyrë që komisionet e vlerësimit të tenderëve bëjnë vlerësim dhe krahasim të drejt të ofertave, që të jet përzgjedhur OE i përgjegjshëm.	Nga mostrat e testuara ne nuk kemi hasur kritere diskriminuese ne dosjet për tender.	I zbatuar
13.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestitim i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Edhe këtë vit komuna ka regjistruar shpenzime në kategori ekonomike joadekuate dhe si rezultat i kësaj kemi pasur keqklasifikime të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatim
14.	Pasuritë	Kryetari duhet të rris performancën e angazhimit tek stafi dhe përmiresoj komunikimin në mes departamenteve, që të sigurohet se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurisë, në mënyrë që të ulet rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë. Po ashtu, kryetari duhet të siguroj se janë marrë masat dhe kapacitetet e nevojshme për të futur në funksion sistemin e-pasuria.	Nuk janë ndërmarrë veprimet ku nga mostrat e testuara kemi identifikuar se blerjet e pasurive nuk ishin regjistruar ne regjistra	Nuk ka filluar zbatim
15.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurohet se bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë si dhe azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Kryetari duhet të analizoj nëse është e nevojshme hartimi i procedurave dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurisë së komunës.	Nuk janë ndërmarrë veprimet nga menaxhmenti dhe komuna nuk kishte bërë krahasimin e raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë.	Nuk ka filluar zbatim
16.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për llogaritë e arkëtueshme dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të sigurohet se prezantimi i tyre në PFV është i saktë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet edhe në këtë vit shpalsje e LL.A në PVF nuk ishte e saktë.	Nuk ka filluar zbatim

17.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Nuk janë ndërmarrë veprime nga menaxhmenti, për vendosjen e mekanzimave për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimi
18.	Detyrimet Kontingjente	Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet kontingjente të prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.	Edhe këtë vitë detyrimet kontingjente nuk janë prezantuar saktë në PVF-të.	Nuk ka filluar zbatimi
19.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e komitetit të auditimit që të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit. Gjithashtu, Komiteti duhet të monitoroj veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit.	Komuna ka funksionalizuar komitetin e auditimit të brendshëm.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit



Albana Sahiti, Anëtare e ekipit



Arian Zenelaj, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Prezantim jo i drejtë i detyrimeve kontigjente në PVF	Ka ndodhur mos koordinimi ndërmjet stafit të ri të rekrutuar dhe stafit të vjetër duke raportuar dy herë të njëjtat detyrime. Në momentin që kemi identifikuar gabimin e kemi korrigjuar duke përditësuar të dhënat si në raportin e bashkëngjitur të detyrimeve kontigjente.	E gjetura qëndron pasi që komuna ka bërë raportim jo të saktë të detyrimeve kontigjente në PVF për vitin 2023 që janë dorëzuar në thesar me gabim.
Hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme, si dhe nënshkrimi i kontratës për projekt të pa planifikuar me ligjin e buxhetit	Këto janë marrëveshje direkte me ndërmarrjet publike dhe pa procedura të prokurimit (gjë që mund të vërtetohet edhe në komuna të tjera të Republikës së Kosovës). Këto aktivitete janë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe varësisht prej punëve që kryhen bëhet edhe faturimi. Sido që të jetë si vlerë referente e disponueshmërisë së mjeteve janë planifikimi i planit të prokurimit për vitin 2023 konkretisht projektet me nr rendor 66 dhe 144 si dhe Buxheti i Kosovës për vitin 2023 kodi i programit 180, kodi nën programit 18032 dhe kodi funksional 0451 - infrastruktura rrugore për vitin 2023-2025 pastaj e ndarë në kategori ekonomike në buxhetin e Komunës për vitin 2023 te kodi ekonomik me nr. 14032-mirëmbajtja e auto rrugëve lokale dhe kodi 14060-mirëmbajtja rutinore. Bashkangjitur gjeni Planet e Prokurimit 2023, Buxhetin e Republikës së Kosovës 2023.	E gjetura qëndron, pasi që është kërkesë ligjore që para se të lidhet çfarëdo kontrate që ka ndikim financiar, organizata buxhetore duhet të siguroj se ka fonde të mjaftueshme duke e nënshkruar edhe deklaratën e disponueshmërisë së fondeve për çka komuna në një rast kishte lidhur kontratë për Mirëmbajtjen e rrugëve dhe shesheve të qytetit pa siguruar deklaratën e disponueshmërisë ku ZKF ka konfirmuar se ka fonde të mjaftueshme buxhetor. Po ashtu në këtë çështje janë edhe gjashtë të gjetura tjera ku komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa mbulesë financiare.

<p>Mos kontraktimi i shërbimeve të cilat ofrohen nga ndërmarrjet publike komunale</p>	<p>Të bashkangjitur keni të gjitha dëshmitë e komunikimit me auditorin e ZKA-së, ku të bashkangjitura janë marrëveshjet me ndërmarrjet publike si dhe gjithë komunikimin në mes komisioneve të ndërsjella ku kanë negociuar për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes të hapsirave publike në qytet dhe fshatra. Gjatë këtyre negociimeve Komuna e Ferizajt ju ka ofruar listën e hapsirave të cilat nevojiten të mirëmbahen dhe gjatë negociatave komisionet e kompanive publike për shkak të kapaciteteve teknike dhe resurseve humane të limituara kanë hyrë në negociata vetëm hapësirat të cilat mund t'i mbulojnë me shërbim duke ju përmbajtur kapaciteteve të tyre (Përkatësisht tek marrëveshjet me KRM Pastërtia dhe NPL Ambienti të cilat janë të bashkangjitura si shtojcë e kësaj shkrese i gjeni të gjitha komunikimet e Komisioneve përkatëse dhe procesverbalet e takimeve për të cilat janë dakorduar për kryerjen e këtyre punëve. Komuna e Ferizajt është detyruar të vazhdoj me procedura të hapura të prokurimit për hapsirat e pa mbuluara nga ana e kompanive publike.</p> <p>Bashkangjitur gjeni marrëveshjet ku janë të përfshira procesverbalet, komunikimet e komisioneve, vendimet për formimin e komisioneve dhe dokumentacioni tjetër përcjellës për dakordimin për kryerjen e punëve përkatëse - dokumentet këto që u janë përcjellë edhe më parë përmes e-mailit.</p>	<p>E gjetura qëndron pasi që komuna nuk ka bërë kërkesë formale në dy (2) Ndërmarrjet Publike Lokale, në të cilat pronare është komuna pronare. Praktikisht pa një kërkesë formale komuna, nuk ka pasur mundësi që ta dijë se Ndërmarrjet Publike Lokale nuk kanë kapacitete për ti kryer shërbimet të cilat ka janë tenderuar dhe është lidhur kontratë me një OE privat, edhe pse këto shërbime janë blerë nga komuna prej këtyre dy Ndërmarrjeve Publike Lokale. Sipas procesverbalit të datës 26.04.2023 të takimit të mbajtur midis zyrtarëve të komunës së Ferizajt dhe zyrtarëve të KRM Pastërtia nuk është diskutuar mundësitë dhe kapacitetet e kompanisë KRM Pastërtia, në atë takim janë bërë negociata për çmimet para se të lidhet kontrata për Pastrimin dhe larjen e rrugëve të zonës urbane të qytetit, largimin dhe bartjen e mbeturinave të vëllimshme, largimin e mbeturinave të ngurta nga hapësirat publike dhe largimin e mbeturinave ilegale të amvisërisë.</p>
<p>Zyrtarë jashtë listës së pagave dhe hyrja në obligime pa buxhet të aprovuar</p>	<p>Drejtoria e Arsimit njofton Zyrën e Auditimit se nga koha kur kemi raportuar për këtë numër e deri më sot ne kemi arritur që të fusim në listen e pagave 7 mësimdhënës që i bie se tani kemi vetëm 24 mësimdhënës jashtë liste, besojmë se ky numër do të zvogëlohet nga muaji në muaj.</p>	<p>E gjetura qëndron pasi që edhe komuna në këtë koment e konfirmon të gjeturën sepse nga koha e raportimi komuna ka arritur ti fus në listën e pagave shtatë (7) mësimdhënës.</p>

<p>Ndryshimi i kontratave të prokurimit duke tejkaluar limitin e lejuar ligjor</p>	<p>Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim një interpretim të KRPP-së, e cila tregon se si KRPP i ka lejuar ndryshimin e kontratës mbi 10% (si në këtë rast 28.5%), duke i theksuar mos kalimin e vlerës totale së kontratës mbi 10%. Ku të gjitha rastet e tejkalimeve të projekteve të Komunës së Ferizajt janë në përputhje me interpretimin e KRPP-së, pra ndryshimi i kontratave është mbi 10%, por jo edhe vlera e kontratës. Bashkëngjitur interpretimi nga KRPP-ja</p>	<p>E gjetura qëndron, pasi që edhe komuna konfirmon se ka ndryshime të kontratave dhe ato ndryshime janë materiale. Çdo ndryshim material i kontratës i cilit do term të saj është i ndaluar me ligjin e prokurimit dhe Rregullën e Prokurimit 001/2022 me nenin 71.5, 71.6 dhe 71.9.2, për shkak se me modifikimin thelbësor të kontratës ndryshon natyra dhe ekuilibri ekonomik i kontratës. E në rastet e cekura në këtë të gjetur ne kemi të bëjmë me modifikime thelbësore të kontratës.</p>
<p>Lëshimi i lejeve të ndërtimi në tokat ku kishin për destinim llojin e shfrytëzimit tokë bujqësore</p>	<p>Sa për sqarimin tuaj Drejtoria e Urbanizmit dhe e Mjedisit ka bërë shndërrimin e tokë bujqësore para rekomandimeve të auditorëve të cilët kanë audituar në tetor të vitit 2023. Të bashkëngjitura gjeni lëndë të natyrës së tillë, si dhe procedurën e shndërrimin e tokës bujqësore në ndërtimore para dhe pas rekomandimit. Dëshminë e gjeni me faturat e lëshuara dhe fletëpagesat e tyre. Bashkëngjitur fletëpagesat përkatëse. Presim që komentet si të tilla dhe dëshmitë e bashkëngjitura t'i merrni parasysh në raportin përfundimtar të auditimit për vitin 2023.</p>	<p>E gjetura qëndron pasi që edhe komuna në këtë koment e konfirmon të gjeturën duke treguar se komuna ka lëshuar leje ndërtimi në toka që kanë certifikat të pronës ku destinimi ka qenë tokë bujqësore dhe pasi që ne kemi vërejtur këtë gjendje, komuna ka filluar të kërkoj ndërrimin e destinimit të tokës para se të lëshohet leja e ndërtimit.</p>
<p>Vonesa në realizimin e kontratës</p>	<p>Drejtoria e Arsimit njofton Zyrën e Auditimit se punët në këtë shkollë janë vonuar për shkak të pengesave që kemi pasur nga AKP-ja, gjegjësisht vendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj për pezullim të punimeve si dhe inflamacioni i vazhdueshëm i çmimeve në treg. (vendimin përkatës të gjykatës dhe shkresën nga AKP, gjeni të bashkëngjitur në shtojcën e kësaj shkrese).</p>	<p>E gjetura qëndron pasi që edhe komuna në këtë koment e konfirmon të gjeturën sepse komuna ka filluar procedurën e prokurimit dhe ka lidhur kontratë pa pasur vend lokacion ku do të ndërtohet shkolla, për çka edhe janë shkaktuar vonesat.</p>



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Ferizajt, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

22.05.2024, Ferizaj



Agim Aliu
Kryetar i Komunës

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁰ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹¹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Meremetimi i aneksit të shkollës fillore ish Shaban Hashani, 30 000€; Asfaltimi i rrugës kryesore dhe trotuarit në lagjen Tafalija në Komogllave, 50 000€; Meremetimi i aneksit të shkollës fillore ish Shaban Hashani, 30 000€; Paisje mjekësore, 16 559€; Rregullimi i Kanalizimit në fshatin Zaskok dhe asfaltimi i rrugëve në Doganaj, 58,548.95; Blerje e pasurisë, 7,238.93€.
- ⁶ Vendim gjyqi, 59,000€; Vendim gjyqi, 53,060€; Shërbimet e varrimit, 28,000€; Ndërtimi i mbikalimit në Ferizaj për hekurudhën afër stacionit policor, 48,888€, Vendim gjyqi, 134,021€; Vendim gjyqi 150,000€, Vendim gjyqi, 33,334€; Furnizimi i fermerëve me serra, 23,705€; Hartimi i projekteve detale, 45,597€, Pajisje mjekësore, 16,559€; Shërbime kontraktuese tjera, 5,000€. Furnizimi me kontejner mbitokësor dhe kontejner shtëpiak, 50,000€, Mirëmbajtja investive, 21,000€, Specifikacion vendimeve gjyqësore, 124,202€.
- ⁷ Pelet, 4,194€; Furnizimi dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore, 22,894€; Vendosja e kamerave në QKMF, 13,697€; Dreka zyrtare, 4,364€; Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objektit të komunës dhe institucioneve tjera që funksionojnë në kuadër të saj, 37,392€; Mirëmbajtja e rrugëve dhe shesheve, 72,225.92 €; Mirëmbajtja e objekteve kulturore, 47,472€; Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit, 3,000€; Hartimi i projekteve detale, 45,597€; Naftë për ngrohje qendrore, 74,580€; Pajisje mjekësore, 16,559€, Furnizime mjekësore, 17,663€, Furnizimi dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore, 34,188€, Furnizimi me vegla pune dhe elektromateriale, 9,973€.
- ⁸ 1)Ujësjiellësi në fshatin Sojeve Dardani, 50,000€, 2)Ujësjiellësi në fshatin Sojeve Dardani, 40,000€, 3) Ndërtimi i sallës sportive, 53,369€, 4) Meremetimi i aneksit të shkollës fillore ish Shaban Hashani, 30,000€, 5) Meremetimi i aneksit të shkollës fillore ish Shaban Hashani, 30,000€, 6) Ndërtimi i aneksit të shkollës së mesme Shaban Hashani, 10,988€, 7) Shtruarja e rrugëve me zhavor, 99,985€, 8) Infrastruktura nëntokësore dhe asfaltimi i rrugicave të mbetura në qytet, 100,000€, 9) Ndërtimi i rrugëve lokale, 100 000€, 10) Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në rrugën Sadik Bega, 33,500€.
- ⁹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹⁰ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹¹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.